



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqënie Sociale
06 Nr. ~~400/01-224~~ dt. ~~12/05/2023~~ 2023



Në vështrim të nenit 8 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, standardet, procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në bazë të Vendimit Nr.01/400/01-22084, të dt. 10.05.2023 për Shpalljen e Thirrjes Publike, gjithashtu bazuar në Thirrjen Publike Nr 06-400/01-22083 dt. 10.05.2023, Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqënie Sociale bënë këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për themelimin e komisionit Vlerësues për mbështetje financiare të

Programeve /projekteve të OJQ-ve

Ftohen dy (përfaqësues në cilësinë e ekspertëve të jashtëm të fushës së OJQ-ve të aplikojnë për Komisionin Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare nga Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqënie Sociale(OMF)

Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

Dokument identifikimi,

Kualifikimi

Kontrata e Punës apo Vërtetimi që është pjesë e punës së OJQ-ve apo Shoqërisë Civile

Disa nga detyrat e Komisionit Vlerësues janë:

I. Të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural sipas procedurës së përcaktuar të nenit 17 të kësaj Rregulloreje dhe vendos nëse aplikantët I plotësojnë kritret e përgjithshme dhe të veçanta të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike.

II. Të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet/propozimet e aplikantëve të kualifikuar për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor, sipas kritereve të nenit 18.

III. Të kërkojë dokumentacionin shtesë të nevojshëm nga aplikuesit pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës

IV. Të përzgjedhë përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike

Thirrja publike është e hapur pesë (5) ditë nga dita e publikimit në web faqen e Komunës së Drenasit. Aplikacionet mund të dorëzohen në sportelin e objektit të Komunës.

